Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0233

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Batisha Ibrahimi dhe Kimete Gashi Brajshori - Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Sabit Makiqi B.I., PI ER TECHNICAL Kft Branch in Kosovo., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, Vendimin për anulimin e proc të Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Mbrojtjes në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me uniforma pune, ceremoniale dhe bendit muzikor per nevojat e FSK-së me numër të prokurimit 217-24-11069-1-1-1, me 30.05.2025,mori:

Vendim

1. Aprovohen, si pjesërisht të bazuara ankesat e OE Sabit Makiqi B.I., me nr. 2025/0233, e datës 04.04.2025, si dhe ankesa e OE PI ER TECHNICAL Kft Branch in Kosovo., me nr.2025/0236 e datës 04.04.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me uniforma pune, ceremoniale dhe bendit muzikor per nevojat e FSK-së me numër të prokurimit 217-24-11069-1-1-1.

2.Anulohet Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për anulim te aktiviteti te prokurimit nga AK – Ministria e Mbrojtjes, lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit, ndërsa lënda kthehet në ri-vlerësim.

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit EkonomikSabit Makiqi B.I., dhe OE PI ER TECHNICAL Kft Branch in Kosovo, konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 06.11.2024, Ministria e Mbrojtjes, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05 Njoftim për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me Furnizim me uniforma pune, ceremoniale dhe bendit muzikor per nevojat e FSK-së me numër të prokurimit 217-24-11069-1-1-1. Ndërsa me datën 18.03.2025 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për anulim te aktivitetit te prokurimit.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 1,735,699euro.

Me 21.03.2025, Sabit Makiqi B.I., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 25.03.2025, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 24.03.2025, PI ER TECHNICAL Kft Branch in Kosovo., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 25.03.2025, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 04.04.2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE Sabit Makiqi B.I., me nr. 2025/0233 për lidhur me aktivitetin "Furnizim me uniforma pune, ceremoniale dhe bendit muzikor per nevojat e FSK-së me numër të prokurimit 217-24-11069-1-1-1.

Me 04.04.2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE PI ER TECHNICAL Kft Branch in Kosovo., me nr. 2025/0236 për lidhur me aktivitetin Furnizim me uniforma pune, ceremoniale dhe bendit muzikor per nevojat e FSK-së me numër të prokurimit 217-24-11069-1-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 0233/2025 dhe ankesa nr. 0236/2025 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Sabit Makiqi B.I., janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi I

AK- e Ministrisë së Mbrojtjes ka bërë shkelje të LPP-së nenin 59, 69 pasi nuk ka vlerësuar ofertën sipas kërkesave të dosjes së tenderit lidhur me referencat, pasi ne e kemi dorëzuar listën dhe referencat. Sa i përket Referencave me kompanitë private Banan store, Kastrati, Runners është dashur t'i kërkojë pagesat që ju kishim dërguar, si dhe referencat tjera në bazë të nenit 10 të

Udhëzuesit duhet të kërkohen. Sa i përket referencës nr. 7 të listës së kontratave, kjo referencë duhet të pranohet pasi është lëfruar malli për atë pjesë/vite është lëshuar referenca dhe AK që ka lëshuar referencën ka qenë i kënaqur, kështu që duhet të pranohet referenca për vlerën e lëshuar. Gjithashtu, edhe referenca që është lëshuar nga Runway shpk, ne e kemi dorëzuar pagesën si dëshmi, siç kërkohet me LPP-në, kështu që AK-ja ka vepruar në kundërshtim me nenin 69 të LPP-së kur kanë vlerësuar gjëra të paqëndrueshme dhe në kundërshtim me kriteret e dosjes së tenderit, ky është një diskriminim i hapur i komisionit të vlerësimit ndaj neve si OE, ku shihet qartë se AK është e obliguar me Ligj që të na trajtojë barabartë në përputhje me LPP-në të gjithë OE-të që ofertojnë e jo të na diskriminojë hapur.

Pretendimi II

Sa i përket pikës 2 të Astari i kapelave që kanë cekur si arsye për eliminim, kjo është sqaruar me pyetje sqaruese të datës 27.12.2024, përgjigjja nr. 4, pasi kanë lejuar të bëhet me metoda të tjera të ndryshimit, dhe në këtë rast nuk mund të arrihen gramazhet e kërkuara, gjithnjë duke u thirrur sipas testimeve të laboratorit. Qëndrueshmëria ndaj pastrimit është bërë përmirësimi me sqarim të datës 27.12.2024, ku me këtë sqarim kërkesat janë përmirësuar. Kjo vërehet te nr. 5, ne kemi bërë sipas metodës të standardit që është kërkuar në specifikimin teknik EN ISO 12947-2, ky standard lidhet me testimin ndaj gërryerjes të tekstileve përmes metodës Martindale, që astari i kapuçit nuk mund të ketë gërryerje pasi nuk ka lëvizje të shumta. Rezultati i laboratorit >10,000 cikle do të thotë që materiali i testuar ka kaluar më shumë se 10,000 cikle Martindale pa degraduar - pa u thyer. Në bazë të këtij standardi, kur kalon më shumë se 10,000 cikle, ky standard zakonisht nënkupton një nivel të mirë rezistencës ndaj gërryerjes, i përshtatshëm për përdorim të moderuar deri intensiv, varësisht nga aplikimi. Pra, në dosje të tenderit nuk është cekur se astari për kapela/uniformat do të përdoren në ambiente të hapura apo në ambiente të mbyllura. Astari është material terciar dhe nuk është materiali kryesor i kapelave dhe uniformave, pasi kjo nuk mund të ketë gërryerje dhe si material terciar nuk mund të vijë deri te dëmtimi i madh, pasi është si material terciar brenda kapelës i materialit kryesor.

Në bazë të kësaj, ne kemi kërkuar një sqarim më të detajuar me na shpjeguar nga laboratori lidhur me këtë standard të Astarit. Laboratori na ka dërguar përgjigjen se Astari i juaj e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit.

Shikoni përgjigjen e laboratorit:

Faqe 7 nga 11

Pretendimi III

Si pikë e eliminimit sipas AK-së është se: Mungon certifikata OEKO TEX lidhur me madhësinë e penjve. Sqarojmë se, nuk qëndrojnë këto konstatime pasi kjo certifikatë e kërkuar nga AK-ja në kërkesat kualifikuese në DT dhe në njoftimin për kontratë nuk ka qenë e kërkuar. Certifikata OEKO TEX ka qenë e kërkuar te specifikimi teknik i DT, që i bie se duhet të sigurohet me dorëzimin e produktit dhe jo në fazën e ofertës.

Gjithashtu, sa i përket kësaj arsye të eliminimit janë të lëshuar disa vendime të OSHP-së, si Vendimi me nr. 2024/0976, 2024/0974, 2024/0980, 2024/0995, nuk qëndron konstatimi i AK-së dhe i komisionit të vlerësimit pasi që qartë shihet se nuk ka bërë vlerësim në përputhje me nenin 59 të LPP-së. Në bazë të nenit 59, vlerësimi i ofertave, AK do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e

parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

AK- e Ministrisë së Mbrojtjes ka bërë shkelje të LPP-së nenin 59 pasi nuk ka vlerësuar ofertën sipas kërkesave të dosjes së tenderit, gjithashtu komisioni i vlerësimit nuk ka vlerësuar ofertën as sipas nenit 72 të LPP-së pasi Autoriteti Kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë Certifikatat dhe dokumentet e paraqitura para njoftimit për kontratë.

Pretendimi IV

Në bazë të specifikimit është kërkuar në DT standardi 20347-2012, kompania jonë ka ofruar në atest, e kemi të cekur: se shtrembi i këpucëve është i qëndrueshëm deri 30°C për rezistencë ndaj shollës së sipërme, përshkueshmëria e ujit rreth 60 minutave, reziston ndaj thithjes së ujit sipas standardit që keni kërkuar.

Ju si AK në asnjë rast nuk keni kërkuar të informoni ofertuesit lidhur me këtë, sqarimi mund të jepet me informacionin lidhur me dosjen dhe sqarimet.

Në fund, kërkojmë nga ju që të ri-vlerësoni ofertën tuaj dhe të merrni vendim më të mirë, pasi që akuzat dhe pretendimet janë të paqëndrueshme dhe abuzive, pasi që po diskutojmë për shkelje të drejtave të konkurrencës, respektivisht eliminimi ynë nga ky tender në mënyrë të paarsyeshme, dhe ftojmë AK-në të rishqyrtojë vendimin e marrë në lidhje me këtë aktivitet të tenderit për dhënie të tenderit dhe të shfuqizoni atë.

Nëse kërkesa jonë nuk shqyrtohet me seriozitetin dhe rreptësinë ligjore, si dhe mos përputhja me LPP, me pasojat që mund të sjellë ky vendim për ne si operator ekonomik, mund të na krijojë dëme të pariparueshme që kanë të bëjnë me reputacionin dhe shëndetin financiar.

Kërkojmë që AK-ja të shqyrtojë kërkesën tonë dhe të korrigjojë vendimin, sipas rregullave dhe procedurave të caktuara me ligj.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim: - Përgjigje nga Ministria e Mbrojtjes.

Përgjigje në pretendimet e Operatorit Ekonomik Sabit Makiqi B.I A&V Collection NP: Pretendimet e juaja nuk qëndrojnë. Komisioni i vlerësimit, në mënyrë të barabartë duke u thirrur dhe respektuar LPP-në, nenin 59 të LPP-së – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve. Komisioni ka vepruar sipas LPP-së dhe kritereve të FTD-së, duke u përmbajtur Neni 60 të LPP-së – Kriter për dhënien e kontratës.

AK ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave në mënyrë të barabartë, sepse vlerësimi i tenderëve është bërë në përputhje të plotë me Ligjin nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë, si dhe Kriterin për Dhënien e Kontratës. Autoriteti kontraktues ka respektuar në tërësi Ligjin nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Autoriteti Kontraktues - Ministria e Mbrojtjes, bazuar në konstatimet e cekura më lartë për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me uniforma pune, ceremoniale dhe bendit muzikor për nevojat e FSK-së" me numër të prokurimit 217-24-11069-1-1-1, ka respektuar në tërësi dispozitat e legjislacionit në fuqi, Ligjin nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe legjislacionin sekondar në fuqi. Bazuar në LPP, andaj mbetet në fuqi njoftimi

mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues i datës 18.03.2025 për anulimin e këtij aktiviteti në mungesë të ofertave të përgjegjshme.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues PI ER TECHNICAL Kft Branch in Kosovo., janë parashtruar si në vijim:

Ne me dt. 18.03.2025 përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me njoftimin mbi vendimin e AK-së ku është anuluar aktiviteti i prokurimit, ndërsa ne jemi shpallur si tenderues i eliminuar me arsyetimin si në vijim:

Arsyeja e lartcekur e autoritetit kontraktues për eliminimin tonë nga ky aktivitet i prokurimit, është e pa bazuar dhe njëkohësisht tendencioze e cila ka për qëllim vetëm eliminimin tone nga ky aktivitet i prokurimit, sepse e njëjta nuk është e mbështetur në asnjë dispozitë konkrete ligjore.

1.Në lidhje me arsyen e parë të eliminimit tonë, ku është cekur se certifikata e akreditimit të BUREAU CONSUMER PRODUCTS SERVICES është me afat të skaduar, ju sqarojmë se e njëjta arsye është e paqëndrueshme. Ne në ofertë përveç certifikatës kemi bashkangjitur edhe një dëshmi nga interneti, përkatësisht nga wefaqja e CNAS (China National Accreditation Service for Conformity Assessment), përmes të cilës vërtetohet fakti se laboratori ku janë kryer testimet e disa produkteve posedojnë certifikatën valide, mirëpo për shkak të disa problemeve teknike nuk kemi mundur të sigurojmë edhe certifikatën e akreditimit me afat valid.

Gjithashtu në lidhje me këtë çështje shumë lehtë AK-ja ka mundur të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së dhe ne do të e kishim prezantuar certifikatën me afat valid të regjistrimit.Sa për korrektësi (Bashkangjitur gjeni certifikatën e akreditimit të laboratorit të lartcekur, me afat valid).

2.Si arsye tjetër për eliminimin tonë nga AK-ja është cekur se raportet e testimeve nuk e përmbajnë emrin dhe numrin e prokurimit të këtij aktiviteti të prokurimit.

Fillimisht po e sqarojmë se në lidhje me këtë arsye të eliminimit nga sistemi i prokurimit e kemi vërejtur që një OE ka parashtruar kërkesë për sqarime për largimin e kërkesës së lartcekur, mirëpo që një kërkesë e tillë nuk është marr parasysh nga ana e AK-së. Në lidhje me arsyen e lartcekur të AK-së ju sqarojmë se e njëjta është e paqëndrueshme për faktin se ashtu siç është cekur edhe nga OE që ka parashtruar kërkesë për sqarime, laboratorët si SGS, TTI dhe të tjerët në të cilët ne kemi kryer testimet përdorin formate standarde ndërkombëtare të testimeve, të unifikuara në nivel global dhe të njëjta për të gjithë klientët, pavarësisht qëllimit të testimeve. Për këtë fakt, nuk mund të bëhen personalizime të raportit sipas kërkesave të një procedure të caktuar prokurimi, pasi kjo gjë është në kundërshtim me procedurat e brendshme dhe rregulloret e akreditimit të laboratorëve.

Gjithashtu duhet cekur fakti se raportet e testimit janë dokumente teknikisht të paanshme dhe të pavarura, të cilat shërbejnë vetëm për të evidentuar rezultatet shkencore të analizave laboratorike. Çdo përfshirje e të dhënave si numri i aktivitetit të prokurimit apo emri i aktiviteti e cenon perceptimin mbi objektivitetin dhe integritetin e raportit.

Po ashtu nëse veç analizohen raportet e testimeve shihet qartë se specifikat teknike të testuara janë në përputhje të plotë me specifikimet teknike të produkteve të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues. Ky fakt është i mjaftueshëm dhe shumë i qartë i cili tregon se testimi i produkteve është bërë pikërisht për këtë aktivitet të prokurimit dhe gjithashtu ky fakt evidentohet qartë në

përshkrimin teknik të raportit të testimit, përmes specifikimeve, modelit, peshës, emrit të operatorit ekonomik dhe specifikimeve tjera të kërkuara nga AK.

Andaj edhe nëse laboratorët do të lejonin të vendoset emri dhe numri i aktivitetit të prokurimit, është shumë e pa nevojshme përfshirja e numrit të procedurës së prokurimit në raport, pasi lidhja e raporteve të testimit me aktivitetin përkatës është e qartë dhe e lexueshme në mënyrë të tërthortë. Ndërsa mos vendosja e emrit të aktivitetit të prokurimit dhe numrit të prokurimit në test raportet e dorëzuara, është dashur të cilësohet si devijim i vogël konform dispozitave të nenit 59.4 të LPP-së, ku specifikohet qartë "4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve".

Në këtë rast përderisa raportet e testimeve janë në përputhje të plotë me specifikimet teknike të kërkuara nga AK-ja, atëherë mos përfshirja e emrit dhe numrit të aktivitetit të prokurimit është devijim i vogël sepse nuk ndikon aspak në kushtet, karakteristikat dhe kërkesat tjera të tenderit.

3.Si arsye tjetër për eliminimin tonë AK-ja e ka cekur se Rripi i brezit, është kërkuar Emblema e FSK me kokën e shqiponjës e gravuar (nxjerrur jashtë). Ky arsyetim i AK-së është i pa bazuar për faktin se mostra e dorëzuar nga ana jonë është i gravuar sipas specifikave të kërkuara në dosje të tenderit, megjithatë siç edhe jeni në dijeni edhe ju si profesionistë, gravimet ne metal mund të bëhen në dy forma:

a) Gravim me laser dhe

b) Gravim 3d

AK-ja nuk e ka specifikuar në dosje të tenderit që gravimi duhet të bëhet me model 3D të gravimit. Ne si OE kemi bërë gravimin e emblemës së FSK-së me kokën e shqiponjës së nxjerrur jashtë, pra gravimi është bërë në metal dhe jo me modelin 3D të gravimit pasi që një kërkesë e tille nuk ka qenë e specifikuar në specifikat teknike.

Për ta sqaruar këtë çështje me fakte konkrete, ju lutem shihni dallimet në mes të gravimit të (nxjerrur jashtë) dhe gravimit me model 3D:

Gravim i nxjerrur jasht me model 3D Gravim i nxjerrur jasht me laser Dallimet në mes gravimit normal dhe gravimit me modelin 3D Modeli 3D i gravimit Modeli normal i gravimit Krijon prerje te thella dhe nxjerr ne sipërfaqe imazhet Krijon prerje dhe imazhe duke gërryer pjesën e metalit Krijon kontura dhe reliefe Bëhet në sipërfaqe Pra, pasi që në dosje të tenderit nuk ka qenë e specifikuar qartazi që gravimi duhet të bëhet me modelin 3D, ne si OE kemi gravuar rripin në fjalë sipas procesit normal të gravimit. Në rast të prodhimit në sasi, gravimi me modelin 3D nuk paraqet aspak problem për neve si OE.

Në lidhje me këtë çështje ne kemi kërkuar sqarime edhe nga një prodhues me eksperiencë 200 vjeçare në uniforma ceremoniale siç është BALP Francë, ku kemi kërkuar sqarimin si në vijim:

Ndërsa kemi pranuar përgjigjjen si në vijim:

Pra edhe nga sqarimi i lartcekur shihet qartë se nga fotografia të cilën e ka vendosur AK-ja në specifika teknike dhe specifikat e shënuara ka dallime nga njëra tjetra sepse në specifika shënohet saktë e gravuar dhe jo gravim 3D.

Duke u bazuar në faktet e lartcekura, përderisa gravimi 3D nuk është specifikuar në dosje të tenderit, atëherë kuptohet qartë se ne si OE jemi eliminuar në kundërshtim me dispozitat e nenit 56.3 të LPP-së, ku specifikohet qartë se "3. Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit".

4.Si arsye tjetër të eliminimit tonë AK-ja e ka cekur se gjysëm topi (plisi) tek shpata, nuk është ofruar me ngjyrë të bardhë vezulluese.

Në lidhje me arsyen e lartcekur të eliminimit tonë, ne kemi kërkuar sqarime nga prodhuesi I shpatës dhe nga i njëjti jemi informuar se ngjyra e përdorur për gjysëm topin (plisin), konsiderohet e bardhë me shkëlqim. Nëse do të përdorej ndonjë nuancë tjetër e bardhë, ajo nuk do të ishte me shkëlqim, siç kërkohet nga autoriteti kontraktues. (Bashkangjitur keni deklaratën nga prodhuesi).

Pra nga sqarimi i lartcekur kuptohet qartë se arsyeja e AK-së për eliminimin tonë është e paqëndrueshme, për faktin se ngjyra e përdorur për plisin është e bardhë me shkëlqim.

Përderisa nuk është specifikuar ndonjë kod për ngjyrën, atëherë ne nuk mund dhe nuk duhet të eliminohemi me një arsyetim të tillë.

Mirëpo edhe përkundër këtij fakti edhe nëse eventualisht AK-ja e sheh të arsyeshme që ngjyra duhet të jetë edhe më e bardhë, atëherë pasi që kemi të bëjmë me ngjyrën e plisit dhe jo me ndryshime materiale në formë të cilat nuk ndikojnë në karakteristikat themelore të shpatës dhe nuk kemi të bëjmë me ndonjë modifikim material, në prodhim me sasi ju informojmë se ne mund të bëjmë ndryshimin e ngjyrës sipas kërkesave të AK-së.

Kur kemi parasysh faktin e lartcekur edhe nëse ngjyra nuk do të ishte sipas kërkesës së AKsë, atëherë ngjyra e plisit do të duhej të cilësohet si devijim i vogël konform dispozitave të nenit 59.4 të LPP-së, sepse nuk kemi të bëjmë me ndryshim material nga karakteristikat e shpatës.

Në dispozitën e lartcekur shënohet qartë "4.Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse:

(i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i

tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve".

Si përfundim ne kërkojmë nga ana e autoritetit kontraktues që ti analizoj në detaje të gjitha faktet e lartcekura dhe pastaj të nxjerr një vendim meritor në lidhje me pretendimet tona ankimore, pasi që pa dashur që kjo gjë të merret si kërcënim, ne jemi të detyruar të vazhdojmë me ankimime edhe në organet tjera kompetente, pasi që po eliminohemi pa ndonjë bazë ligjore.

Ne kemi pasur qasje në dokumentet e OE Sabit Makiqi B.I. A&V -Collection NP, dhe kemi analizuar dokumentet e të njëjtit, ku kemi ardh në përfundim se i njëjti është i papërgjegjshëm për faktet si në vijim:

Fillimisht pajtohemi me arsyet e eliminimit të AK-së, në lidhje me papërgjegjshmërinë e të njëjtit ku është shënuar:

OE i lartcekur është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk ka prezantuar katalogun sipas kërkesës së dosjes së tenderit ku është kërkuar "Kerkesa 10. Operatori ekonomik duhet të paraqesë, tek Autoriteti kontraktues të paktën nga një foto për secilin produkt, së bashku me specifikacionin teknik per mallrat e ofruara me një përshkrim të karakteristikave teknike te detajuara dhe standardeve me qellim qe te jet i mundur vlerësimi i specifikave teknike siq kërkohet në specifikimet teknike DT (Aneksi 1) (p.sh. në formën e një katalogu)", ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar "Evidenca 10. Katalogu ose broshura nga prodhuesi".

OE i lartcekur ka prezantuar një katalog i cili është kopje e specifikimeve teknike dhe jo katalog i prodhuesit.

Faktin se katalogu i prezantuar është kopje e specifikimeve teknike, vërtetohet edhe nga fotoja e mëposhtme e marr nga "katalogu" i të njëjtit OE:

Katalogu nuk mund dhe nuk duhet të përmbaj edhe sqarimet e AK-së në lidhje me penjtë të cilat AK-ja i ka bashkangjitur në specifikat teknike. Pra në këtë rast vërtetohet fakti se katalogu është kopje e specifikimeve teknike dhe jo katalog i prodhuesit.

OE i lartcekur është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk e ka plotësuar edhe kërkesën tjetër të dosjes së tenderit ku është specifikuar "Kërkesa 13 Operatori Ekonomik duhet te ofroj Atestet laboratorike për artikujt me nr. rendor 1, 8, 16, 20, 22, 31, 35, 39, 42, 45, 49, 56 dhe 58 sipas specifikave teknike te kërkuara", ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar "Evidenca 13 a) Raportet e Atestimit duhet të jen të kryera nga një laborator i cili është i certifikuar sipas standardit ISO 17025 2018, Atestet /Raportet e testimit duhet të kenë emrin e aktivitetit dhe numrin e prokurimit,

c) Kopja e certifikatës së Laboratorit të akredituar (Certifikatën e akreditimit të laboratorit sipas standardit ISO 17025 2018". Nga analiza që i kemi bërë raporteve të testimeve të prezantuar nga OE i lartcekur ne i kemi vërejtur disa ndërhyrje ne raporte të cilat po i sqarojmë si në vijim:

Për produktet: Kapelë e rrumbullaket me strehë A (për meshkuj); Këmishë me mëngë të shkurtër dhe jakë të shtrira-meshkuj (bezh); Setër Solemne për ceremoni (me shirit në fund të mëngëve)-meshkuj; Setër Solemne për darka zyrtare (me shirit dhe dekorim në fund të mëngëve)-meshkuj; Pantollona solemn (me shirit anësor dekorues ngjyrë ari)-

meshkuj; Xhaketa vere (cermoniale); Pantallona verorë (cermoniale) meshkuj dhe Kapela për meshkuj (cermoniale); kur analizohen në detaje raportet e të njëjtit, shihen qartë ndërhyrjet të cilat janë bërë tek rezultatet e materialeve. Dyshimet tona për ndërhyrje bazohen tek ndryshimi i fontit të numrave dhe njëkohësisht kur klikohet mbi rezultate hijezohen vetëm numrat ku ka ndërhyrje.

Me qëllim që të vërtetohet fakti se a janë të bazuara apo jo dyshimet tona, kërkojmë nga ana e OSHP-së që ti analizoj në detaje edhe një herë raportet e testimeve të prezantuara nga OE i lartcekur dhe të komunikohet direkt me laboratorin me qëllim që të vërtetohet se a janë të njëjta rezultatet e testimeve të raporteve të cilat i ka lëshuar laboratori me raportet e dorëzuara nga OE i lartcekur.

Kërkojmë që të merret parasysh ky pretendim i yni pasi që ndërhyrja (falsifikimi) në raporte të testimeve përbën shkelje të rëndë dhe një gjë e tillë është e dënueshme me ligj.

Autoriteti kontraktues nuk i ka analizuar në tërësi mostrat e prezantuara nga OE i lartcekur për faktin se i njëjti nuk e ka prezantuar shpatën sipas kërkesave të dosjes së tenderit.

Plisi në fund të shpatës nuk është me ngjyrë vezulluese siç është kërkuar nga AK-ja, mirëpo çuditërisht AK-ja nuk e ka eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për këtë pikë, ndërsa të kundërtën e ka bërë me ne duke përdorur kështu standarde të dyfishta.

Andaj duke u bazuar në të gjitha faktet e lartcekura, kuptohet qartë se OE i lartcekur është dashur të eliminohet nga aktiviteti i prokurimit edhe për këto arsye, pasi që të njëjtat nuk i ka plotësuar.

Ne me dt.25.03.2025 kemi pranuar vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, ku AK-ja është arsyetuar se kërkesa për rishqyrtim është e pa bazuar, mirëpo nuk ka dhënë asnjë arsyetim konkret për një refuzim të tillë.

Autoriteti kontraktues në vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim nuk ka dhënë asnjë përgjigjje në lidhje me pretendimet tona ankimore, mirëpo vetëm është arsyetuar si në vijim:

Ky arsyetim i autoritetit kontraktues është i pa bazuar dhe njëkohësisht shumë i përgjithshëm, sepse e njëjta pa i analizuar fare pretendimet tona ankimore ka dhënë një përgjigjje të tillë.

Përveç pretendimeve tona ankimore për arsyet e eliminimit tonë, ne në kërkesë për rishqyrtim kishim parashtruar edhe pretendime të cilat kanë të bëjnë me dyshime për falsifikim të dokumenteve të tenderit, ndërsa përveç që pretendimet për arsyet e eliminimit tonë AK-ja është e detyruar të i shqyrtoj, njëkohësisht me prioritet të lartë është dashur të konsiderohen edhe dyshimet për falsifikim të dokumenteve.

Me përgjigjjen e saj autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 108/A të LPP-së paragrafi 9 ku specifikohet qartë "9. Refuzimi do të arsyetohet dhe do ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë. Për më tepër autoriteti kontraktues mund të pengojë procedurën e mëtejshme, me pranimin e një njoftimi me shkrim nga ankuesi në lidhje me gatishmërinë e tij për të tërhequr kërkesën e paraqitur për shqyrtim".

Përderisa autoriteti kontraktues nuk ka dhënë përgjigjje konkrete në lidhje me pretendimet tona ankimore, në këtë rast kuptohet qartë se pretendimet tona ankimore janë të bazuara, sepse në të

kundërtën AK-ja do të kishte kundërshtuar secilin nga pretendimet tona ankimore duke dhënë fakte dhe përgjigjje konkrete me qëllim të vërtetimit se pretendimet tona ankimore nuk qëndrojnë. Përderisa një veprim të tillë AK-ja nuk e ka bërë, atëherë nga të gjitha faktet kuptohet qartë se pretendimet tona ankimore janë të qëndrueshme, andaj edhe ankesa jonë duhet të aprovohet si e bazuar.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se është vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së, e po ashtu nuk është respektuar fare neni 60 i LPP-së.

Pra duke i pasur parasysh të gjitha faktet në lidhje me kronologjinë dhe ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit, rezulton se ky aktivitet i prokurimit është anuluar në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së, sepse nuk janë përmbushur asnjëra nga kushtet e parashikuara në këtë dispozitë.

Anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit është bërë në kundërshtim edhe me nenin 43.5 dhe 43.7 i Rregullores nr.001/2022 Për Prokurim Publik, sepse nuk janë plotësuar asnjëra nga kushtet e kësaj dispozite, ndërsa ju sqarojmë se ne jemi ofertues i përgjegjshëm dhe i plotësojmë të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente, ndërsa AK-ja nuk e ka zbatuar këtë dispozitë sepse ne jemi eliminuar dhe diskriminuar pa ndonjë bazë ligjore, duke mos na rekomanduar për kontratë edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe kemi ofertuar me çmim më të ulët.

Po ashtu nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim: - Përgjigje nga Ministria e Mbrojtjes.

Përgjigje në pretendimet e Operatorit Ekonomik PIER TECHNICAL Kft Branch in Kosovo: Pretendimet e juaja nuk qëndrojnë. Komisioni i vlerësimit, në mënyrë të barabartë, duke u thirrur dhe respektuar LPP-në, nenin 59 të LPP-së – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve. Komisioni ka vepruar sipas LPP-së dhe kritereve të FTD-së, duke u përmbajtur Neni 60 të LPP-së – Kriter për dhënien e kontratës.

AK ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave në mënyrë të barabartë, sepse vlerësimi i tenderëve është bërë në përputhje të plotë me Ligjin nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë, si dhe Kriterin për Dhënien e Kontratës. Autoriteti kontraktues ka respektuar në tërësi Ligjin nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Autoriteti Kontraktues - Ministria e Mbrojtjes, bazuar në konstatimet e cekura më lartë për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me uniforma pune, ceremoniale dhe bendit muzikor për nevojat e FSK-së" me numër të prokurimit 217-24-11069-1-1-1, ka respektuar në tërësi dispozitat e legjislacionit në fuqi, Ligjin nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe legjislacionin sekondar në fuqi. Bazuar në LPP, andaj mbetet në fuqi njoftimi

mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues i datës 18.03.2025 për anulimin e këtij aktiviteti në mungesë të ofertave të përgjegjshme.

Ndërsa për ankesën 2025/0233 me datën 29.04.2025 rekomandimi si ne vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues aprovohet pjeserisht e bazuar ndersa mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës me nr.0233/2025 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, është pajtuar ndërsa OE nuk është pajtuar rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Ndërsa për ankesën 2025/0236 me datën 30.04.2025 rekomandimi si ne vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues aprovohet pjeserisht e bazuar ndersa mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës me nr.0236/2025 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues ndërsa OE nuk pajtohet rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

-Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE Sabit Makiqi B.I.,- eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0233 ka vlerësuar si në vijim:

Pretendimi nr.1

Pretendimet kryesore sipas ankesës 233/25 ka të bëjë me arsyen e eliminimit të OE në këtë rast ankues, ku sipas AK-së ky OE është eliminuar për disa arsye.

Sa i përket pretendimeve ankimore lidhur me referenca, certifikata OEKO Tex dhe qëndrueshmërisë së penjësve, konsiderojmë se janë pretendime ankimore pjesërisht të bazuara në kuptimin e asaj që AK për dokumente që mungojnë ose duken të jenë jo të plota, në pajtim me LPP ka mund të kërkoj sqarime shtesë nga OE. Megjithatë janë dy arsye të eliminimit të dhëna nga AK të cila konsiderojmë se janë të bazuara dhe japim sqarim si më poshtë.

Pretendimi nr.2

Lidhur me arsyen e eliminimit nga AK ku për kërkesë të dosjes që astari të jetë 80 gram për metër katror , duke lejuar devijim 5% ndërsa OE ankues ka ofruar 103 gram, OE ankues në ankesë nuk jep sqarime të mëtutjeshme lidhur me këtë arsye te eliminimimt, megjithat përmes ankesës ofron një sqarim nga laboratori testues, i cili sqarim sipas mendimit tonë vetëm se

vërteton pasi edhe sqarimi laboratorit konstaton se mostra testuar tejkalon peshën 80 gram me tolerancë+/- 5%.

I njëjti raport poashtu konfrimon se produkti/materiali nuk është testuar deri në 20000 cikle.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Lidhur me pretendimet e OE PI ER TECHNICAL Kft Branch in Kosovo., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0236 ka vlerësuar si në vijim:

Pretendimi nr.1

Pretendimi i parë ankimor sipas ankesës 236 /25 ka të bëjë me arsyen e eliminimit të OE në këtë rast ankues, ku sipas AK-së ky OE ka ofruar certifikatë të laboratorit me afat të skaduar.

OE ankues pretendon se me sqarime i ka ofruar certifikatën valide e po ashtu në ankesë bashkangjet edhe përkthimin e kësaj certifikate nga gjuha kineze.

Fillimisht sarojmë se sqarimi dhe plotësimi i dokumenteve që mungojnë ose duken të jenë jo të plota është i lejuar edhe me LPP, megjitahtë kushti është që ekzistenca e dokumenteve të tilla duhjet të jetë e mundur të që mënyrë objektive të verigfikohet se dokumentet kanë ekzistuar para afatit të fundit për dorëzim të tenderit.

Në rastin konkret certifikata në gjuhë kineze mban datat 2022-08-10 dhe 2028-08-09.

OE ankues pretendon se kjo certifkatë është shkarkuar nga faqaja zyrtare e CNAS (China National Accreditation Service for Conformity Assessment) në shqip "Shërbimi kombëtar Kinez i akredimit për vlerësimin e konformitetit", megjithatë OE nuk ka ofruar ndonjë link përmes të cilit ne do të mund të konfirmonim një gjë të tillë.

Ne kemi tentuar që përmes faqes zyrtare të "Shërbimi kombëtar Kinez i akredimit për vlerësimin e konformitetit" të gjejmë certifikatën në fjalë, duke përdorur numrin e certifikatës si dhe emrin e kompanisë mirëpo nuk kemi gjetur rezultate.

Edhe kodi i reagimit te shpejt (QR Code) i cili gjendet ne certrtifikatë, i cili pas skanimit me telefon do duhej të shpinte drejtë për drejtë në certifikatën në fjalë, edhe pas disa tentimeve te skanimit të këtij kodi nuk kemi pasur rezultat pozitiv.

Bazuar në këto qëu cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar.

Vlen te theksohet se edhe sikur te mund te konfirmonim ekzistencen dhe validitetin e certifikates se kontestuar, kjo nuk do sillte ndryshim rezultat final per arsyet te cilat do ti cekim ne vijim.

Pretendimi nr.2

Sa i përket pretendimit për arsyen e eliminimit se raportet e testimit nuk mbajnë emrin dhe numrin e këtij prokurimit, OE pretendon se një detaj/informatë e tillë nuk mund të shtohet në raporte të testimit pasi bie ndesh me rregullat e brendshme të laboratorit si dhe me rregullat e akredimit.

Nga përvoja që kemi pasur ne si ekspert disa here për testime të ndryshme të mostrave/materialeve, shpesh kemi hasur se klienti (prodhuesi) mund të cek arsyet pse kërkon të

bëhet testimit, tek të cilat arsye konsideorjmë se ka mund të shkruhet emri dhe numri i prokurimit.

Përveq kësaj, OE ose prodhuesi ka mund të kërkoj nga laboratori një shkresë përcjellëse përmes të cilës konfirmon se testimi është bërë për qëllim të pjesëmarrjes në prokurimin e caktuar.

Si do që të jetë, emri dhe numri aktivitetit të prokurimit në raporte të testimit ka qenë kërkesë decidivie në dosje të tenderit dhe kosndeorjmë se nuk mund të anashkalohet, andaj vlerësojmë se pretendimi ankimorë nuk është i bazuar.

Pretendimi nr.3

Sa i përket arsyes së eliminimit të mostrave, se rripi nuk e ka të gravuar (të nxjerrur jashtë) kokën e shqiponjës dhe se shpata te fundi dorezës gjysëm topin nuk e ka ngjyr të bardh shkëlqyese, OE pretendon se janë të pabazuara,.

OE sqaron se rripi është i gravuar me laser dhe është në pajtim me kërkesat e dosejs pasi nuk është cekur se gravimi duhet të jetë 3D.

Ndërsa sa i përket ngjyrës së gjysëm topit të shpatës pretendon se prodhuesi këtë e kosnideropn ngjyrë të bardhë, por edhe sikur të mos jetë ngjyr e bardhë pretendopn se kjo duhet konsiderohet devijim i vogël.

Në ciëlsi të ekspertit shqyrtues ne kemi kërkuar nga AK të na ofroj si dëshmi fotografitë e mostrave të OE ankues.

Pas analizimit të këtyre dëshmive, konsiderojmë se qart mund të shihet se mostrat e ofruara nuk janë në pajtim me kërkesat e dosjes.

Emblema e FSK në rrip shihet se është e gravuar mirëpo jo e "nxjerrur jashtë" siq ka qenë kërkesa e dosejs, por është komplet e rrafshëët.

Po ashtu tek shpata, gjysëm topi tek doreza shihet se është ngjyrë e verdhë (ngjyrë ari), dhe nuk e kuptojmë OE ankues se në qfar formule mund të konsiderohet ngjyarë e verdhë apo e ngjyarë e arit si ngjyrë e bardhë!

Provë : foto e mostrës, gjysëm topi ngjyre ari : të njëjtë e gjeni të bashkëngjitur në raportin e ekspertizës.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendmi ankimorë është i pabazuar

Pretendimi nr.4

Sa i përket pretendimeve ankimore lidhur me OE tjetër pjesëmarrës, sqarojmë se edhe ai OE është eliminuar nag AK si i papërgjgjshëm, megjithatë OE shton arsye tjera shtesë për papërgjgjshmërinë e ati OE, duke cekur edhe dyshimet për falsifikime.

Fillimisht duhet të sqarojmë se eksperti sqhyrtues i OSHP-së nuk ka kapacitet teknik/profesional e as kompetencë për të vërtetuar falsifikim apo modifikim të dokumenteve, dhe për këtë pretendim OE mund ti drejtohet organeve kompetente.

Po ashtu mund të konfirmojmë se nga arsyet e eliminimit të dhëna nga AK për OE tjetër, ne përmes raportit 233/25 kemi konfirmuar të paktën dy arsye të eliminimit të cilat sipas mendimit tonë janë të pakontestueshme, dhe ato janë pesha e materialit, dhe mungesa 200000 cikleve ne testim të laboratorit.

Pretendimet tjera kundrejt OE tjetër pjesëmarrës sa i përket katalogut, shpatës etj, konsiderojmë se janë pjesërisht të bazuara mirëpo në çfarëdo rrethane nuk sjellin ndryshim në rezultat final për shkak të arsyeve që cekëm më lart, të cilat e bëjnë ofertën OE Sabit Makiqi B.I të papërgjegjshme.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues pas vlerësimit dhe administrimit të provave sipas ankesës së dorëzuar sqaron se konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues për këtë lëndë nuk janë në tërësi të qëndrueshme. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues nuk i ka falur besimin në tërësi raportit të ekspertit shqyrtues sa i përket pretendimeve të operatorit ekonomik ankues.

Vlen të theksohet fakti se për Panelin Shqyrtues, konstatimet dhe rekomandimet e ekspertëve shqyrtues nuk janë të detyrueshme, por shërbejnë vetëm si një provë në mesin e të gjitha provave tjera që vlerëson në secilën lëndë veç e veç. Paneli Shqyrtues vendos në mënyrë të pavarur, objektive dhe me kujdesin e duhur profesional duke mbrojtur gjithmonë interesin e publikut përmes LPP dhe legjislacionit sekondar në fuqi për prokurimin publik.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e Furnizim me uniforma pune, ceremoniale dhe bendit muzikor per nevojat e FSK-së me numër të prokurimit 217-24-11069-1-1-1.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik Sabit Makiqi B.I., të aprovohet si pjesërisht e bazuar. Paneli Shqyrtues duke marre parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik e sheh si pjesërisht të bazuar, dhe konsideron se në kuptim të nenit 1, 6 dhe 7 dhe me qëllim që të analizohen të gjitha faktet dhe argumentet e ofruara nga OE ankues atëherë, vendos që këtë aktivitet të prokurimit me titull "Furnizim me uniforma pune, ceremoniale dhe bendit muzikor per nevojat e FSK-së" me numër të prokurimit 217-24-11069-1-1-1 ta kthej në ri-vlerësim dhe AK konform nenit 59 dhe 72 të LPP të kërkoj sqarime shtesë.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik PI ER TECHNICAL Kft Branch in Kosovo.të aprovohet si pjesërisht e bazuar. Paneli Shqyrtues duke marre parasysh përshkrimin

dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik e sheh si pjesërisht të bazuar, dhe konsideron se në kuptim të nenit 1, 6 dhe 7 dhe me qëllim që të analizohen të gjitha faktet dhe argumentet e ofruara nga OE ankues atëherë, vendos që këtë aktivitet të prokurimit me titull "Furnizim me uniforma pune, ceremoniale dhe bendit muzikor per nevojat e FSK-së" me numër të prokurimit 217-24-11069-1-1-1 ta kthej në ri-vlerësim dhe AK konform nenit 59 dhe 72 të LPP të kërkoj sqarime shtesë sa i përket çertifikatave dhe testimeve, ndërsa lidhur me rripin, AK në konsultim me njësinë e kërkesë le ta ri-shqyrtoj, rëndësinë e gravimit dhe të ngjyrës së këtij rripi, sepse AK ka mundësinë që këtë ta konsideroj edhe si devijim i vogël konform nenit 59.4 të LPP.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale-Departamenti Administratë në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **MINISTRIA E MBROJTJES, MINISTRIA E MBROJTJES**
- OE - **Sabit Makiqi B.I., PI ER TECHNICAL Kft Branch in Kosovo**
- Arkivës së OSHP-së: